



**BASHKIA  
TIRANË**  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr.122 , datë 28.09.2020**

**“PËR  
SHPËRBLIMIN E KLUBIT TË FUTBOLLIT TIRANA, SI REZULTAT I FITIMIT TË  
KAMPIONATIT KOMBËTAR TË FUTBOLLIT 2019-2020”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, Vendimit nr. 14, datë 12.10.2011, “Për transformimin në shoqëri aksionare të Klubit të Futbollit Tirana, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë aksionare “Klubi i Futbollit Tirana”, të ndryshuar, Vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, në vijim të shkresës me nr. 134/1 prot., datë 14.9.2020, të Klubit të Futbollit Tirana sh.a drejtuar Bashkisë Tiranë, si dhe në vijim të memos nr.31406 prot., datë. 18.09.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Promovimit të Qytetit” me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Shpërblimin e klubit të futbollit Tirana (sportistëve, stafit teknik dhe stafit mbështetës) në shumën prej 15.000.000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë, si rezultat i fitimit të Kampionatit Kombëtar të Futbollit 2019-2020, që përkon dhe me 100-vjetorin e themelimit të këtij klubi.
2. Shpërblimi i akorduar sipas pikës 1 të këtij vendimi, do të lëvrohet drejtpërdrejtë nga Bashkia Tiranë në llogarinë bankare të përfituesve, sipas listës së vlerave të përcaktuara në listën bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen duke pakësuar projektet kulturore në programin e Trashëgimisë Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore në buxhetin e vitit 2020 në vlerën 15.000,000 (pesëmbëdhjetëmilion)lekë dhe duke shtuar në të njëjtën vlerë buxhetin e programit të Sport dhe Argëtim, Aparati i Bashkisë zëri “Akordim fondi për shpërblimin e futbollistëve, stafit teknik dhe stafit mbështetës të Klubit të Futbollit Tirana Sh.a” artikulli 606.
4. Ngarkohet kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij për nënshkrimin e kontratave individuale me përfituesit e shpërblimit, sipas përcaktimeve në këtë vendim.
5. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**TONI GOGU**